



Mesazh i Shoqatës Universale të Esperantos për Ditën e Gjuhës Prindore, 21 shkurt 2024

Në këtë ditë, Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Prindore, në shpjem përpara rëndësinë e ndryshimësisë gjuhësore dhe edukimit shumëgjuhësh. Të drejtat gjuhësore janë themel për shoqëritë e drejta dhe të qendrueshme, sepse gjuhët janë zemra e jetës sonë të përditshme, e identitetit, trashëgimisë kulturore dhe unitetit bashkësior. Gjuhët janë një bazë për t'i qasur liritë e tjera njerëzore.

Mbrojtja dhe shpuarja përpara e gjuhëve ka rëndësi shumë të madhe, sepse nëpërmjet gjuhëve barten pikëpamjet botërore dhe ruhen dijet e kulturat vendore dhe tradicionale. Për fat të keq, sipas UNESCO-s, 40 përqind e popullsisë botërore nuk ka qasje në arsim në gjuhën që e flet dhe e kupton. Njëkohësisht, gjithnjë e më shumë gjuhë po zhduken.

Në shoqëritë tona gjithnjë e më shumë pluraliste dhe përpara idesë së shoqërisë mbarëbotërore që përfshin tërë njeërzimin, çështja e gjuhëve merr përparësi. Në fakt, gjuhët janë një themel absolut i mirëkuptimit dhe bashkëpunimit. Kështu, të drejtat gjuhësore kanë lidhje drejtpërdrejt me demokracinë dhe vendimet e vërteta të përbashkëta për problemet e përbashkëta.

T'i shpjem përpara vlerat e botës shumëgjuhëshe të propozuara nga UNESCO: mësimdhënien në gjuhët prindore, arsimin shumëgjuhësh në të gjitha nivelet dhe edukimin ndërkulturor. Kështu, shpresojmë që paqja, zhvillimi dhe të drejtat e njeriut të bëhen një realitet për të gjithë njerëzit, pa asnjë lloj dallimi, si racor, nga ngjyra e lëkurës, seksi, gjuha, feja, politika apo mendimi ndryshe, prejardhja kombëtare apo shoqërore, prona, lindja apo gjendje tjetër.

Me anë të gjuhëve ne bashkëndajmë njerëzinë tonë. T'i përdorim dhe t'i bëjmë të dobishme të gjitha gjuhët, përfshi edhe gjuhën ndërkombëtare Esperanto, për t'i vënë në jetë këto parime dhe vlera. Për të festuar solidaritetin ndërmjet njerëzve me prejardhje të ndryshme, ne i ftojmë njerëzit vullnetmirë në Kongresin Universal të Esperantos në Arusha, Tanzani, ndërmjet 3 dhe 10 gushtit 2024.